



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:038183

Datë: 11.09.2018

Numri i dokumentit: 00117179

P.nr.404/17

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Xh. N. R. nga fshati T., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës së PTH në Prizren PP.II.nr.161-1/17 të dt.25.05.2017, në seancën gjyqësore të mbajtur me dt.10.09.2018, në prezencë të PSH Milot Krasniqi, të akuzuarit, muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari Xh. R., nga i ati N., e ëma S., i lindur më dt.15.06.1955, nga fsh. T., ku dhe tani jeton, ka të kryer arsimin e mesëm, i ve, me profesion vozites, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me dt. 04.01.2017 rreth orës 18,20 minuta në rrugën lokale S. – V., saktësisht te vendi i quajtur “T.” në fsh. S. Komuna e Suharekës, duke mos iu përmbajtur dispozitave të komunikacionit në rrugë, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë,vepron në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, në atë menyrë që i pandehuri duke drejtuar automjetin (furgon) të markës C. J. me shenje të regjistrimit 04-....-CC, i cili kishte ndermarrë veprime të pasigurta ku kishte filluar kthimin majtas në momentin kur automjeti i markës “O. K.” me shenjë regjistrimi 04-...-CC, i cili ishte pas tij veq kishte filluar tejkalimin e automjetit 2 C. J.” dhe në moment kur ka filluar kthimi, në atë moment me pjesën e perparme të majtë e ka goditur automjetin “O. K.” pas goditjes që kishte pësuar, automjeti “O. K.” kishte dal jashtë rruge ne anën e majtë dhe ishte ndalur në një lëndinë. Në këtë rast lëndime të lehta trupore kanë pësuar të dëmtuarit G. Sh. dhe Z. Sh., lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertëve mjeko ligjor Dr. D. H. dhe dr. M. G. të dt. 15.02.2017

Këso dore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP.

Gjykata në kuptim të nenit 41, 51,52,73,74 ,si dhe neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

## DENIMIN ME KUSHT

Të akuzuarit X. R. duke ia vërtetuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një viti, nga dita e plotëfuqishmeris së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës , në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 €, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumen prej 20 €, ne emër të ekspertit të komunikacionit shumën prej 40.88 € dhe taksen per kompenzim te viktimave te krimit shumen prej 30 €.

Të dëmtuarit Z. dhe G. Sh. që të dy nga fshati V., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

PTH nga Prizreni me aktakuzën PP.II.nr.161-1/17 të dt. 25.05.2017, ka akuzuar Xh. R. nga fshati T., aktakuzen të cilen gjate séancës gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e saj e ka përfaqësuar PSH Milot Krasniqi, i cili në tërsi ngel pran të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.10.09.2018 dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit, ka vërtetuar këte gjendje faktike:

Në tersi është vërtetuar se me datën 04.01.2017 rreth orës 18,20 minuta në rrugën lokale S. – V., saktësisht te vendi i quajtur “T.” në fsh. S. Komuna e Suharekës, duke mos iu përmbajtur dispozitave të komunikacionit në rrugë, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë,vepron në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit per rregullat e trafikut rrugor, në atë menyrë që i pandehuri duke drejtuar automjetin (furgon) të markës C. J. me shenje të regjistrimit 04-...-CC, i cili kishte ndermarrë veprime të pasigurta ku kishte filluar kthimin majtas në momentin kur automjeti i markës “O. K.” me shenjë regjistrimi 04-...-CC, i cili ishte pas tij veq kishte filluar tejkalimin e automjetit 2 C. J.” dhe në moment kur ka filluar kthimi, në atë moment me pjesën e perparme të majtë e ka goditur automjetin “O. K.” pas goditjes që kishte pësuar, automjeti “O. K.” kishte dal jashtë rruge ne anën e majtë dhe ishte ndalur në nje lëndinë. Në ketë rast lëndime të lehta trupore kanë pësuar të dëmtuarit Gj. Sh. dhe Z. Sh., lëndime këto të përshkuara më për së afërmi në mendimin e ekspertëve mjeko ligjor Dr. D. H. dhe dr. M. G. të dt. 15.02.2017

Ketë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim fillestar në mbrojtjen e tij vullnetarisht e ka pranuar fajsin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP, në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin fillestar dhe pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza siq janë : raporti i oficerit me nr. 2017-GR-0013 të dt.04.01.2017, raporti i QKMF në Suharekë me nr.469, 471 të dt. 04.01.2017, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor Dr.D. H. dhe M. G. të dt.15.02.2017, mendimi i ekspertit të komunikacionit S. Sh. si dhe fotodokumentacioni të cilat gjinden në shkresat e lëndës si prova materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis në shqyrtimin fillestar nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248, nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hudhjen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale nga neni 253 të KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP, gjithashtu në këtë drejtim shkon edhe fakti që i akuzuari ka pranuar fajsin në tërsi, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor, dhe ia shqiptoi denimin siq është cek në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi denimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KP, të cilat ndikojnë në lartësin e denimit.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasyshë se i akuzuari ka patur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tërsi të veprës së kryer, asnjëherë me parë nuk ka ra ndesh me ligjin, kurse rrethana posaqerisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 paragrafi 1 të KPP.

## **GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA NË SUHAREKË** **P.nr. 404/17 të dt.10.09.2018**

Sek. Juridike  
F. Kabashi

G j y q t a r i  
Robert Tunaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.